VENDIM
Nr.494, datë 1.8.2007

PËR MIRATIMIN E NORMAVE TË TRAJTIMIT ME USHQIM TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË STUDENTËVE DHE KURSANTËVE NË SHKOLLAT E POLICISË DHE TË SHTETASVE TË NDALUAR, DERI NË SQARIMIN E POZITËS SË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 127 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e Policisë së Shtetit, studentët e kursantët, në shkollat e policisë, brenda vendit, dhe kursantët, që trajnohen në institucione të tjera të Policisë së Shtetit, të trajtohen me ushqim, pa pagesë.

Normat e ushqimit ditor përcaktohen dhe miratohen nga Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Shëndetësisë.

2. Trajtimin me ushqim, pa pagesë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, e përfitojnë edhe:

a) shtetasit e huaj, që hyjnë ilegalisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, deri në sqarimin e pozitës së tyre;

b) shtetasit shqiptarë, të kthyer nga vendet e tjera, deri në sqarimin e pozitës së tyre;

c) shtetasit shqiptarë, të cilët qëndrojnë në mjediset e komisariateve, deri në dërgimin e tyre në mjediset e paraburgimit (të shoqëruar e të ndaluar).

3. Trajtimi me ushqim, sipas shkronjave "a", "b" e "c", të pikës 2, bëhet sipas normës së miratuar nga Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Shëndetësisë.

4. Punonjësit e policisë, që përfitojnë të drejtën e trajtimit me ushqim për një vakt, "drekë", në strukturat, që nuk kanë infrastrukturën e duhur për ushqim të gatuar, të kompensohen, për ditët efektive të punës, në vlerë (në lekë), sipas vlerës së racionit bazë ushqimor për vaktin e drekës, të miratuar nga Ministri i Brendshëm.

5. Ministri i Brendshëm, në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë, miraton normat e ushqimit ditor për çdo strukturë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

6. Ministri i Brendshëm miraton:

a) strukturat e Policisë së Shtetit, që përfitojnë ushqim me tri vakte a me një vakt;

b) normat e zëvendësimit të artikujve ushqimorë, brenda limitit të miratuar të k/kalorive, duke ruajtur raportin e njësive ushqimore;

c) normat e pajisjeve dhe të materialeve të shërbimit të ushqimit;

ç) kompensimin e ushqimit në vlerë (në lekë) për strukturat, që e përfitojnë të sipas shkronjës "b" të pikës 2 të këtij vendimi;

d) rastet e kompensimit në vlerë, kur, për shkak të detyrës, punonjësit e policisë dhe ata, që e përfitojnë ushqimin, sipas pikës 2, nuk mund të konsumojnë ushqim të gatuar.

7. Vendimet nr.160, datë 9.7.1975, nr.139, datë 27.4.1990, nr.439, datë 10.10.1992, nr.545, datë 29.12.1992, nr.341, datë 9.7.1993, nr.13, datë 24.1.1994, nr.402, datë 25.6.2004, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

8. Në vendimin nr.505, datë 24.10.1994 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me ushqim të kuadrove ushtarakë aktivë, që shërbejnë në strukturat e ushtrisë", të ndryshuar, fjalët " Ministrisë së Brendshme", shfuqizohen.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha